PROJEKTE TË FINANCUARA NGA AKKSHI

1. Titulli i projektit: **NJË QASJE E INTEGRUAR E BAZUAR NË PYETJE NË MËSIMDHËNIEN E ANGLISHTES SI GJUHË E HUAJ: NDËRTHURJA E METODËS SOKRATIKE, NXJERRJES SË NJOHURIVE PËRMES PYETJEVE DHE ZBULIMIT TË UDHËHEQUR PËR TË PËRMIRËSUAR PËRVETËSIMIN E FJALORIT DHE GRAMATIKËS TE NXËNËSIT SHQIPTARË.**

Qëllimi i projektit: Projekti synon të hartojë, të zbatojë dhe të vlerësojë një qasje të integruar për mësimdhënien e anglishtes si gjuhë e huaj, duke ndërthurur metodën sokratike, nxjerrjen e njohurive përmes pyetjeve dhe zbulimin e udhëhequr. Qëllimi kryesor është të shqyrtojë nëse dhe në ç'masë kjo qasje i ndihmon nxënësit të përvetësojnë fjalorin dhe gramatikën e gjuhës angleze. Studimi shqyrton gjithashtu pjesëmarrjen, motivimin dhe të menduarit kritik të nxënësve, si dhe mënyrën se si nxënësit dhe mësuesit e vlerësojnë zbatimin e qasjes në klasë.

Përshkrimi i projektit: **Projekti kontribuon në fushën e shëndetit publik duke:**

Projekti shqyrton si mund të përdoren pyetjet në orën e anglishtes për t'i ndihmuar nxënësit të kalojnë nga njohja e një fjale ose rregulli te përdorimi i tij në kontekst. Tri metodat kanë role plotësuese: pyetjet sokratike i nxisin nxënësit të arsyetojnë dhe të rishikojnë përgjigjet; nxjerrja e njohurive përmes pyetjeve i ndihmon të shprehin atë që dinë tashmë; ndërsa zbulimi i udhëhequr i orienton të krahasojnë shembuj dhe të nxjerrin kuptime ose rregulla me mbështetjen e mësuesit.

Studimi parashikohet të zhvillohet në shkollën "Koto Hoxhi" në Gjirokastër me dy grupe nxënësish të moshës 12–14 vjeç, me nivel A2 në anglisht. Gjatë disa njësive mësimore, grupi eksperimental do të punojë me qasjen e integruar, ndërsa grupi i kontrollit do të ndjekë mësimdhënien e zakonshme. Ndërhyrja do të zbatohet dhe monitorohet në bashkëpunim me mësuesin e anglishtes të klasës. Për shembull, nxënësit mund të krahasojnë fjali të shkurtra, të shpjegojnë çfarë ndryshon në formën e foljes dhe të provojnë rregullin që kanë nxjerrë duke ndërtuar fjali të reja.

Studimi ndërthur kërkimin në veprim me krahasimin e rezultateve të dy grupeve të formuara paraprakisht,para dhe pas ndërhyrjes mësimore. Të dy grupet do të zhvillojnë teste para dhe pas ndërhyrjes. Testet do të përmbajnë si ushtrime me përgjigje të përcaktuara, për shembull plotësim boshllëqesh, ashtu edhe detyra të hapura, si ndërtimi i fjalive dhe shkrimi i udhëhequr. Krahasimi i rezultateve do të tregojë si ka ndryshuar

performanca në fjalor dhe gramatikë në secilin grup.Vëzhgimet e strukturuara dhe regjistrimet audio do të ndihmojnë të analizohet si zhvillohet dialogu në klasë dhe si marrin pjesë nxënësit. Intervistat gjysmë të strukturuara me nxënësit dhe mësuesit do të japin të dhëna për motivimin dhe për lehtësitë ose vështirësitë e zbatimit. Shënimet reflektuese të nxënësve të grupit eksperimental, ditari i kërkimit dhe analiza e materialeve mësimore do të ndihmojnë në interpretimin e rezultateve të testeve.

Në bazë të gjetjeve do të formulohen rekomandime praktike për hartimin e pyetjeve dhe organizimin e veprimtarive të fjalorit dhe gramatikës në orët e gjuhës angleze.

2. Titulli i projektit: **NDIKIMI I PERSONALITETIT NË ORIENTIMIN E KARRIERËS SË MATURANTËVE NË QARKUN GJIROKASTËR**

Qëllimi i projektit: Të analizojë në mënyrë empirike marrëdhënien ndërmjet tipareve të personalitetit dhe orientimit profesional të maturantëve në Qarkun Gjirokastër, përmes një studimi shkencor të bazuar në instrumente psikometrike të standardizuara, me synim prodhimin e evidencës së matshme dhe të publikueshme shkencërisht gjatë 30 muajve.

Përshkrimi i projektit: **Projekti kontribuon në psikologji dhe edukim përmes përmirësimit të orientimit akademik dhe profesional të maturantëve.**

Projekti synon të analizojë marrëdhënien ndërmjet tipareve të personalitetit dhe orientimit profesional të maturantëve në Qarkun Gjirokastër, përmes një studimi empirik të mbështetur në instrumente psikometrike të standardizuara. Studimi do të përfshijë 523 maturantë dhe do të synojë identifikimin e lidhjeve ndërmjet karakteristikave individuale të personalitetit, interesave dhe preferencave profesionale të tyre.

Nëpërmjet një qasjeje ndërdisiplinore, që ndërthur psikologjinë dhe shkencat e edukimit, projekti synon të krijojë një model empirik që do të shërbejë si bazë për përmirësimin e proceseve të orientimit dhe këshillimit të karrierës në shkolla. Rezultatet pritet të ofrojnë evidencë shkencore dhe rekomandime praktike për psikologët shkollorë, mësuesit e orientimit profesional dhe institucionet arsimore.

Gjatë periudhës 1 korrik 2026 – 31 dhjetor 2028, projekti do të fokusohet në realizimin e kërkimit shkencor, publikimin e rezultateve në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, organizimin e një konference shkencore dhe pjesëmarrjen në konferenca brenda dhe jashtë vendit.

Projekti synon të kontribuojë në zhvillimin e kërkimit shkencor, përmirësimin e praktikave të orientimit profesional dhe mbështetjen e

maturantëve në marrjen e vendimeve të informuara për të ardhmen e tyre akademike dhe profesionale.

3. Titulli i projektit: **MODELI NDËRDISIPLINOR SI MEKANIZËM PËR FUQIZIMIN SOCIAL DHE AKADEMIK TË FËMIJËVE ME AFTËSI NDRYSHE**

Qëllimi i projektit: Projekti ka për qëllim hartimin, pilotimin dhe vlerësimin e një modeli ndërdisiplinor të mbështetjes në arsimin bazë, i cili synon fuqizimin social dhe akademik të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe përmirësimin e cilësisë së praktikave gjithëpërfshirëse në shkollë. Në qendër të tij qëndron krijimi i një qasjeje të integruar të bashkëpunimit ndërmjet mësuesve të arsimit fillor, mësuesve ndihmës, shërbimit psikosocial, specialistëve të fushave të tjera, drejtuesve të institucioneve arsimore dhe familjeve. Përmes koordinimit të përgjegjësive profesionale, planifikimit të përbashkët dhe përdorimit të të dhënave për progresin e nxënësve, projekti synon të mbështesë pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor, zhvillimin e kompetencave dhe ndërveprimin social të fëmijëve.

Përshkrimi i projektit: **Projekt kontribuon në tre fusha kryesore:**

Projekti kërkimor-shkencor zbatohet nga Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër, me financim nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), për periudhën 1 korrik 2026 – 31 dhjetor 2028. Ai synon zhvillimin dhe testimin e një modeli ndërdisiplinor për përmirësimin e mbështetjes sociale dhe akademike të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet mësuesve, specialistëve dhe familjeve.

Në fazën e parë do të realizohet një studim mbi praktikat gjithëpërfshirëse në shkollat e territorit të Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, me pjesëmarrjen e të paktën 300 mësuesve të arsimit fillor dhe mësuesve ndihmës. Përmes pyetësorëve do të identifikohen problematikat, nevojat dhe sfidat që lidhen me bashkëpunimin ndërdisiplinor, planifikimin didaktik dhe mbështetjen e nxënësve.

Bazuar në rezultatet e studimit dhe literaturën shkencore, do të hartohet një model ndërdisiplinor që përfshin mekanizma bashkëpunimi, koordinimi, planifikimi dhe monitorimi të progresit të nxënësve, duke vendosur në qendër nevojat individuale të fëmijëve dhe përfshirjen e familjes.

Modeli do të pilotohet në gjashtë shkolla nëntëvjeçare, me qëllim vlerësimin e zbatueshmërisë dhe ndikimit të tij në zhvillimin social dhe akademik të nxënësve. Në përfundim, rezultatet do të shpërndahen përmes

publikimeve shkencore, trajnimeve dhe rekomandimeve për institucionet arsimore.

Projekti synon të ofrojë një model të mbështetur në kërkimin shkencor dhe të testuar në praktikë, duke kontribuar në zhvillimin profesional të personelit arsimor dhe forcimin e kulturës së gjithëpërfshirjes në arsimin parauniversitar.

4. Titulli i projektit: **VLERËSIM SEROEPIDEMIOLOGJIK I HEPATITIT B NË PERSONELIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR PARËSOR DHE SPITALOR NË GJIROKASTËR**

Qëllimi i projektit: Projekti ka si qëllim të përditësojë panoramën epidemiologjike të Hepatitit B në popullatë duke i ofruar kësaj të fundit teknologjinë laboratorike më të mirë të kohës, e cila i mungon institucioneve shëndetësore lokale.

Përshkrimi i projektit: **Projekti kontribuon në fushën e shëndetit publik duke:**

a. Vlerësuar imunizimin ndaj virusit të Hepatitit B (HBV) në popullatë nëpërmjet matjes së nivelit serologjik të anti-Hbs.
b. Vlerësuar përhapjen e infeksionit në popullatë nëpërmjet matjes së nivelit serologjik të HbsAg.
c. Identifikuar ekspozimin ndaj burimeve të mundshme të infeksionit me HBV në popullatën në studim.

5. Titulli i projektit: **ANALIZA E TREGUT DHE RIDIZENJIMI I KURRIKULAVE UNIVERSITARE NË UNIVERSITETIN "EQREM ÇABEJ", DUKE IU PËRGJIGJUR ZHVILLIMEVE RAJONALE DHE FORCIMIT TË MISIONIT TË TRETË TË UGJ-SË**

Qëllimi i projektit: Të përmirësojë përputhjen dhe relevancën e programeve të studimit të ofruara prej Universitetit "Eqrem Çabej" me kërkesat aktuale dhe të ardhshme të tregut të punës, për të rritur aftësinë dhe kompetencat e punësimit të të diplomuarve dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit.

Përshkrimi i projektit: **Projekt kontribuon në tre fusha kryesore:**

a. Inovacioni në metodologji në studimin e tregut të punës: Përmirëson metodologjitë e kërkimit në shkencat e aplikuara dhe fondamentale përmes analizës së të dhënave të avancuara dhe teknikave produktive për të studiuar tregun e punës.

b. Zhvillimi i politikave në edukim: Ndihmon në zhvillimin e politikave dhe praktikave në edukim të përshtatura me nevojat e tregut të punës, duke u bazuar në të dhëna të sakta dhe analiza të detajuara.
c. Lidhja midis arsimimit dhe tregut të punës: Forcon lidhjen midis tre komponentëve (që korespondojnë dhe me 3 misionet) e arsimit të lartë, mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe lidhjes efektive me tregun e punës dhe ofrimin e shërbimeve për të tretët, duke promovuar një qasje të integruar që adreson nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë.

6. Titulli i projektit: **EKTOPARAZITËT E SHPENDËVE NË SHQIPËRI EDHE KOSOVË DHE ROLI I TYRE NË TRANSMETIMIN E PATOGJENËVE ME RËNDËSI NË SHËNDETIN PUBLIK**

Qëllimi i projektit: Qëllimi kryesor i këtij studimi mbetet përcaktimi i prevalencës dhe karakterizimi gjenetik i popullatave të ektoparazitëve qarkullues në tufat e mbarështimit të shpendëve (dhe gjithandej në shpendë), në Shqipëri dhe Kosovë, por edhe të ektoparazitëve të tjerë si *Menopon gallinae*. Me vlerë dhe impakt plotësues në vlerësimin e parazitëve qarkullues do të jenë dhe studimi i efikasitetit të kontrollit terapeutik si dhe vlerësimi i rolit vektorial të *D.gallinae* në transmetimin e infeksioneve zoonotike bakteriale, me rëndësi për Shëndetin Publik dhe Shëndetin Publik Veterinar.

Përshkrimi i projektit: Mjedisi, kafshët dhe bimët janë të ndjeshme ndaj infestimeve parazitare [Agosta et *al.,* 2010]. Tek shpendët shtëpiakë ekto-parazitët jane një çështje shumë problematike kryesisht të lidhur me llojet *Dermanyssus gallinae* dhe *Menopon gallinae*, por mund të jenë edhe parazitë tjerë, të cilët janë dëmtues të përhapur masivisht në shpendët dhe mjediset e mbarështimit të shpendëve në mbarë globin [Sparagano et al., 2014]. Megjithëse *D. gallinae* raportohet të jetë një parazitozë specifike e shpendëve shtëpiakë dhe atyre të mbarështuar me qëllim prodhimin e mishit dhe vezëve, në shumë studime janë evidentuar më shumë se 30 lloje shpendësh të egër, të ndjeshëm ndaj këtij infestimi [Roy et *al.*, 2007].
Dermanyssus gallinae është një ektoparazit obligator që ushqehet me gjakun e shpendëve. Nivelet e moderuara deri në të larta të infestimit kanë ndikime negative në mirëqënien dhe shëndetin e shpendëve, përfshirë këtu rritjen e kanibalizmit, stresit, shkuljen-dëmtimin e pendëve, aneminë dhe ngordhshmërinë.
Administrimi i akaricidëve është aktualisht mënyra mbizotëruese e kontrollit të shëndetit të tufës për *D. gallinae*, megjithëse rezistenca ndaj disa klasave të ndryshme të anti-parazitarëve është raportuar gjerësisht.

Zhvillimi i rezistencës anti-parazitare nxjerr në pah një nevojë në rritje për kërkime në metodat alternative të kontrollit, duke përfshirë më vonë prodhimin e një vaksine të përshtatshme dhe efektive [Karp-Tatham et *al.,* 2020].

Kryerja e këtij studimi ka një rëndësi të madhe në mjedisin e shpendarisë, në rëndësinë veterinare, në shëndeti publik dhe kontrollin medikamentoz.

7. Titulli i projektit: **PËRMIRËSIMI I EFIÇENCËS SË PRODHIMIT DHE SIGURISË SË PUNËTORËVE NË INDUSTRINË E TEKSTILEVE: NJË PROJEKT KËRKIMOR BASHKËPUNUES MIDIS UNIVERSITETIT "EQREM ÇABEJ" DHE KOMPANISË “MARIKATEX**

Qëllimi i projektit: Të adresojë sfidat me të cilat përballet industria e tekstilit në rajonin jugor të Shqipërisë, të përmirësojë mirëqenien e punëtorëve, të optimizojë proceset e prodhimit, të rrisë konkurrencën dhe të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik të industrisë.

Përshkrimi i projektit: Projekti synon të arrijë objektivat e mëposhtëm:

Rritja e mirëqenies dhe sigurisë së punëtorëve: Një nga qëllimet kryesore është përmirësimi i kushteve të punës për punonjësit në industrinë e tekstilit. Kjo përfshin adresimin e çështjeve të tilla si pagat e ulëta, orët e gjata dhe mjediset e pasigurta të punës.

Optimizimi i zinxhirit të prodhimit: Projekti synon të optimizojë zinxhirin e prodhimit të tekstilit. Industria e tekstilit është një sistem kompleks me procese të ndërlidhura, dhe projekti synon të identifikojë fushat me joefikasitet, të zvogëlojë kostot e prodhimit dhe të rrisë efikasitetin e përgjithshëm.

Promovimi i konkurrencës: Industria e tekstilit në rajonin jugor të Shqipërisë përballet me konkurrencë të ashpër nga vendet fqinje si Turqia dhe Greqia, të cilat kanë kosto më të ulëta prodhimi dhe efikasitet më të lartë. Projekti synon ta bëjë industrinë tekstile shqiptare më konkurruese duke përmirësuar produktivitetin, duke ulur kostot dhe duke rritur cilësinë e produkteve.

Informimi i politikave dhe vendimmarrjes: Hulumtimi i kryer si pjesë e projektit pritet të ofrojë njohuri të vlefshme që mund të informojnë politikat kombëtare dhe rajonale dhe proceset e vendimmarrjes. Kjo përfshin promovimin e rritjes dhe zhvillimit të qëndrueshëm brenda industrisë së tekstilit.

8. Titulli i projektit: **Studimi i kapacitetit kullosor në qarkun e Gjirokastrës**

Qëllimi i projektit: Të studiojë kapacitetin kullosor në Qarkun e Gjirokastrës, për të krijuar një ide të qartë për numrin e krerëve ekziztuse në varësi të kapaciteteve kullosore të maleve në qarkun Gjirokastër.

Përshkrimi i projektit: Blegtoria është një sektor agroushqimor shumë i rëndësishëm në Qarkun e Gjirokastrës. Rreth 1/2 e fermerëve janë të angazhuar në blegtori. Studimi i kapacitetit kullosor të kullotave ka një impakt të drejtpërdrejtë tek blegtorët për të parë kapacitetin kullosor në përputhje me numrin e krerëve në këto kullota.

9. Titulli i projektit: **ZHVILLIMI EKONOMIK I LUGINËS SË VJOSËS NËPËRMJET TURIZMIT ALTERNATIV (QARKU GJIROKASTËR)**

Qëllimi i projektit: Identifikimi i aktiviteteve turistike dhe investimeve të domosdoshme për zhvillimin e Turizmit Alternativ në Luginën e Vjosës, me qëllim shfrytëzimin maksimal të potencialit natyror të zonës dhe rritjen e mirëqenies së përgjithshme të komunitetit lokal.

Përshkrimi i projektit Zhvillimi i Turizmit Alternativ konsiderohet si një mënyrë e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në përgjithësi. Turizmi lumor është një prej alternativave të këtij turizmi. Meqënëse lumi Vjosa është një nga lumenjtë e fundit të egër në Evropë me gjatësi rreth 272 km, prej të cilave 80 km në territorin e Greqisë dhe 192 km brenda territorit të Shqipërisë, lugina e tij ofron potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit lumor. Por lugina e Vjosës dhe zonat përreth kanë potenciale të mëdha zhvillimi edhe për disa lloje të tjera të turizmit alternativ siç janë turizmi natyror, kulturor, kulinar, agroturizëm etj. Sipas ndarjes territoriale të vitit 2014 lugina e Vjosës shtrihet në qarqet Korçë (8.75%), Gjirokastër (50.47%), Vlorë (30.59%), Fier (10.13%), Berat (0.06%) dhe sipërfaqja më e madhe, por edhe me më shumë interes turistik, ndodhet në Qarkun Gjirokastër, duke ofruar mundësi të mëdha për zhvillimin e turizmit në këtë zonë. Zhvillimit ekonomik dhe turistik të kësaj zone i ka munguar një studim i mirëfilltë i strategjive dhe aktiviteteve që duhet të ndërmerren me qëllim shfrytëzimin maksimal të potencialit natyror dhe përmirësimin e standardit të jetesës për popullsinë rurale të kësaj zone. Ky projekt synon të përmbushë këtë nevojë, me qëllim ndërgjegjësimin e komunitetit lokal për mundësitë që ka

si edhe nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve për investime të mëtejshme.

10. Titulli i projektit: **"PROGRAMI I PËRBASHKËT MIDIS UNIVERSITETIT TË GJIROKASTRËS (SHQIPËRI) DHE UNIVERSITETIT TË MAÇERATËS (ITALI), NË CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE "MASTER I SHKENCAVE" NË ARKEOLOGJI, HISTORI DHE ADMINISTRIM I PASURIVE KULTURORE-ASPIC".**

Qëllimi i projektit: Të ofrohet një mundësi e re studimi e ciklit të dytë "Master i Shkencave" në programin e studimit ASPIC, në Universitetin e Gjirokastrës dhe në Universitetin e Maceratës, me mundësi për shkëmbim të stafit akademik dhe administrativ dhe studentëve, në përfundim të të cilit do të fitohen dy diploma kombëtare të Universiteteve pritëse (*diplomë e dyfishtë*).

Përshkrimi i projektit: Projekt mbi programin e përbashkët midis Universitetit të Gjirokastrës (Shqipëri) dhe Universitetit të Maçeratës (Itali), në Ciklin e dytë të studimeve "Master i shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive kulturore-ASPIC, në përfundim të të cilit, studenti do të marrë titullin e dyfishtë të Diplomës "Master i shkencave" Histori dhe Arkeologji për Inovacion, të Universitetit të Maçeratës (Itali) dhe "Arkeologji, histori dhe administrim i pasurive kulturore" të Universitetit të Gjirokastrës (Shqipëri).

Një diplomë universitare me titull: "*Kërkime historike dhe burime të kujtesës*" dhe "*Administrim i pasurive kulturore historike dhe arkeologjike*" është mjaft fleksibël përsa u përket mundësive që kanë studentët për punësim, si specialistë që mund të punësohen në:

- Zyrat teknike të enteve publike: Ministria e Kulturës, Qarqet e rretheve, Bashkitë etj.
- Institucionet e lidhura me ruajtjen, menaxhimin dhe studimin e pasurisë arkeologjike.
-Institutin e monumenteve të kulturës, drejtoritë rajonale të monumenteve të kulturës, parqet arkeologjike, zyrat e trashëgimisë kulturore, Institutin Albanologjik etj.
-Në organizmat private që kanë për objekt studimin dhe menaxhimin e vlerave arkeologjike.
-Në universitete vendase dhe të huaja që kanë për objekt studimi trashëgiminë kulturore.

11. Titulli i projektit: **"NGRITJA E LABORATORIT TË SIG-UT SI DHE I INFRASTRUKTURËS HAPËSINORE, PRANË NJËSISË BAZË TË HISTORISË, ANTROPOLOGJISË DHE GJEOGRAFISË".**

Qëllimi i projektit: Projekti synon të zhvillojë aftësitë e studentëve në hartimin e punimeve shkencore në gjeografi, duke u njohur me kriteret, metodologjitë dhe standardet shkencore e gjuhësore të tyre. Gjithashtu, synon të ofrojë njohuri teorike dhe praktike mbi Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS), digjitalizimin, mbledhjen, përpunimin dhe analizimin e informacionit gjeografik, si dhe përdorimin e programeve dhe pajisjeve për krijimin dhe interpretimin e hartave, grafikëve dhe tabelave në funksion të kërkimit shkencor dhe zbatimeve praktike.

Përshkrimi i projektit: Kërkimi Shkencor në Gjeografi dhe Sistemet e Informacionit Gjeografik, janë disiplina formuese bashkohore të cilat synojnë të pajisin studentët me njohuri teorike edhe praktike. Ato i përgjigjen sfidave në të tashmen por edhe në të ardhmen. Kompletimi i studentëve me dije nga këto disiplina të reja do t'ju shërbejë të bëjnë punime shkencore dinjitoze dhe me vlera. Gjithashtu do ti bëjë ata më të përgatitur, më racionalë me kërkesat që kërkon punësimi.

Në pjesën e parë të lëndës trajtohet domosdoshmëria e njohjes me punimet shkencore, fazat që ndiqen për krijimin e tyre, duke i konkretizuar me shembuj konkretë. Për krijimin e një shkrimi në fushën e gjeografisë nevojitet jo vetëm ana shkencore e trajtimit por edhe ana organizative, redaksionale etj, elementë këta që ia rrisin vlerën akoma më shumë një punimi shkencor.

Ndërsa pjesa e dytë e lëndës ka të bëjë me sistemet e informacionit gjeografik, disiplinë kjo e cila ka revolucionarizuar një sërë shkencash përfshirë këtu edhe gjeografinë. Duke qenë një displinë përmbledhëse e arritjeve të një sërë shkencash ajo jep ndihmë në modernizimin dhe realizimin e objektivave tek ato.

Me anë të GIS studentët do të kuptojnë se mbledhja, analizimi, strukturimi dhe ndërtimi i database ku integrohen informacioni hapësinor dhe ai gjeografik i shërben nevojave të studjuesve dhe institucioneve për të nxjerrë përfundime sa më racionale për fenomene e dukuri të ndryshme gjeografike ose jo.

12. Titulli i projektit: **DIGJITALIZIMI I INFRASTRUKTURËS SË MËSIMDHËNIES NË UOGJ, 6 KLASA**

Qëllimi i projektit: Projekti synon të rrisë njohuritë dhe aftësitë e studentëve mbi rëndësinë e modernizimit dhe digjitalizimit të infrastrukturës arsimore, si dhe përdorimin e teknologjive dhe mjeteve digjitale në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, garantimit të vijimësisë së

procesit mësimor dhe përafrimit të praktikave arsimore me standardet evropiane.

Përshkrimi i projektit

Projekti synon digjitalizimin e infrastrukturës së mësimdhënies në UGJ, duke u gërshetuar me oportunitetet që ofrojnë Biblioteka Digjitale Universitare në Shqipëri, ashtu sikurse edhe ato të universiteteve partnere me universitetet shqiptare, investimet e shumta që qeveria jonë ka bërë në fushën e digjitalizimit të jetës sociale dhe ekonomike, nevojat e tregut të punës për fuqi punëtore të familjarizuar me përdorimin e teknologjisë së digjitalizuar, etj. Auditorët digjitalë (konkretisht, 6 klasa digjitale) do të vihen në shërbim të mësimdhënies dhe bashkëpunimit me partnerët e universitetit tonë. Ky projekt do të mundësojë:

1. Përdorimin gjatë procesit mësimor në auditor ose në mësimin online i software-ve mësimore të tipit laboratore virtuale dhe software-ve të tjerë në funksion të studimeve kërkimore-shkencore;
2. Klasat digjitale mundësojnë përfshirjen në kohë reale në procesin mësimor të studenteve të cilët nuk mund të marrin pjesë fizikisht në procesin mësimor;
3. Klasat digjitale mundësojnë rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies duke ndikuar në mënyrë të padiskutueshme në rritjen e aftësisë së të diplomuarve për t'u përshtatur me tregun e punës, i cili përditëson në mënyrë të vazhdueshme teknologjinë dhe mënyrat e operacioneve të veta;
4. Klasat digjitale do të shërbejnë si infrastrukturë bazë e mësimdhënies për programet e studimit apo të trajnimit online të cilat universiteti ynë i ka në fokusin e objektivave të veta afatshkurtra.

13. Titulli i projektit: **DIGJITALIZIMI I LABORATORIT PËR KRYERJEN E STUDY TOUR VIRTUAL 3D NË TURIZËM**

Qëllimi i projektit: Modernizimi i infrastrukturës së nevojshme për mësimdhënie bashkëkohore në programet e studimit të degës së turizmit, duke i ndihmuar studentët që të pasurojnë dhe përmirësojnë eksperiencat e tyre të mësimdhënies/mësimnxënies në mënyrë cilësore dhe efiçente.

Përshkrimi i projektit

Nga sondazhet e kryera me studentët tanë, pavarësisht se informacioni teorik është i bollshëm, shqetësim kryesor përbën fakti se ata gjatë periudhës së shkollimit, vizitojnë pak ose aspak destinacione apo burime turistike. Meqënëse organizimi i vizitave fizike (study-tour) në destinacione turistike ka vështirësitë e veta për tu realizuar, laboratori

digjital mundëson kryerjen e ekspeditave virtuale turistike në format 3D për destinacionet kryesore turistike të qarkut: bujtina, ferma agroturizmi, parqe arkeologjike dhe natyrore, objekte të turizmit kulturor, kala etj. Pra laboratori digjital ju ofron studentëve mundësinë që nëpërmjet vizitave studimore virtuale të njohin burimet më të rëndësishme turistike të Qarkut Gjirokastër.

14. Titulli i projektit: **PROJEKT KËRKIMOR PËR APLIKIMIN E ICT NË MËSIMDHËNIEN E ICT**

Qëllimi i projektit: Projekti synon të përgatisë profesionistë të kualifikuar në fushën e informatikës dhe teknologjisë së informacionit, përmes ofrimit të mësimdhënies cilësore, përditësimit të vazhdueshëm të njohurive dhe zhvillimit të kërkimit shkencor. Ai synon të nxisë inovacionin, mendimin kritik, bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe zbatimin e teknologjive të reja në funksion të zhvillimit shoqëror, si dhe të promovojë të nxënit gjatë gjithë jetës dhe përgatitjen e mësuesve të informatikës për t'iu përgjigjur sfidave të zhvillimit teknologjik.

Përshkrimi i projektit: Duke u bazuar në planifikimin e aktiviteteve të projektit, është ndërtuar një strukturë e qëndrueshme e cila lehtëson implementimin e projektit në kohë dhe në objektiva, nëpërmjet disa fazave:

Faza e parë - përfshin ndërtimin e infrastrukturës së rrjetit kompjuterik, dhe ngritjes e krijimit të laboratorëve në universitet.

Faza e dytë - përfshin aktivitetet për ndërtimin e software-it, i cili konsiston në dizenjimin, programimin dhe integrimin e modulit të regjistrimit (web dhe mobile), në dizenjimin, programimin dhe integrimin në platformë të modulit e-learning, përgatitjen e materialeve të trajnimit të cilat do të hidhen më pas në platformë nga grupi i punës, si dhe përditësimin e modulit të testimit nëpërmjet programimit, duke shtuar funskionalitete të reja dhe duke e bërë më user-friendly.

Faza e tretë - përfshin implementimin, gjatë së cilit do të instalohen dhe konfigurohen të gjitha pajisjet e rrjetit kompjuterik, sipas nevojave të platformës, trajnimin e administratorëve të sistemit, trajnimin e mësuesve dhe nxënësve, testimin dhe përditësimet e fundit të sistemit, si dhe testmin e nxënësve.

Faza e katërt - përfshin kërkimin shkencor, i cili është një nga synimet e projektit, dhe konsiston në mbledhjen dhe analizën e të dhënave, të mbledhura nga platforma, vlerësimin e impaktit dhe përmirësimin e

sistemit. Do të konkludohet me disa artikuj të cilët do të publikohen më pas në revista dhe konferenca shkencore. Në këtë fazë do të vlerësohet kuptueshmëria e projektit nga aktorët e përfshirë, si dhe aplikueshmëria e projektit. Gjithashtu, do të vlerësohet efektiviteti i grupeve të punës dhe qëndrueshmëria e projektit, ku laboratorët e krijuar në kuadër të këtij projekti do të përdoren, sipas nevojave të identifikuara nga analiza e të dhënave, si qendër trajnimi për mësuesit, në mënyrë të vazhdueshme, përkundrejt një pagese, e cila do të vendoset pas një procesi të kujdesshëm vlerësimi.

15. Titulli i Projektit: **STANDARTIZIMI I PRODUKTEVE TË BLEGTORISË NË QARKUN E GJIROKASTRËS DHE KRIJIMI I NJË MARKE TREGTARE.**

Qëllimi i projektit Të standartizohen produktet blegtorale të prodhuara në Qarkun e Gjirokastrës, për të krijuar një linjë produktesh dhe nënproduktesh të qumështit, të cilat do të tregtohen në një markë të vetme tregtare.

Përshkrimi i projektit: Blegtoria është një sektor agroushqimor shumë i rëndësishëm në Shqipëri. Rreth 1/2 e fermerëve janë të angazhuar në blegtori, duke përfshirë sektorin e bulmetit. Qarqet me përqëndrimin më të lartë të prodhimit të qumështit nga të imtat janë Vlora, Gjirokastra, Korça dhe Elbasani, të cilët të gjithë bashkë përbëjnë më shumë se 1/2 e prodhimit total.

Kryesisht në zonat periferike të qarkut të Gjirokastrës, por edhe në zonat urbane ka fermerë të vegjël të cilët prodhojnë qumështin dhe nënproduktet e tij, dhe i tregtojnë ato pa një emër tregtar dhe pa strategji të penetrimit në treg.